



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 3414 Prot.

Tiranë, më 23.6. 2020

UDHËZIM

NR. 17, DATË 23.6. 2020

PËR

**DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 15.5.2019
“PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019, i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Në pikën 1, të shkronjës “C”, të kreut II, togfjalëshi “... deri në 7 (shtatë)” zëvendësohet me togfjalëshin “...deri në 10 (dhjetë)”.
 - b) Në pikën 1, të shkronjës “E”, të kreut II, togfjalëshi “... deri në 5 (pesë)” zëvendësohet me togfjalëshin “...deri në 10 (dhjetë)”.
 - c) Në pikat 2 dhe 5, të shkronjës “A”, të Kreut III, togfjalëshi “... 6 faza 48-orëshe”, zëvendësohet respektivisht me togfjalëshin “...7 (shtatë) faza 48-orëshe”.
 - d) Në pikat 2 dhe 5, të shkronjës “D”, të Kreut III, togfjalëshi “... 4 faza 48-orëshe”, zëvendësohet respektivisht me togfjalëshin “... 5 (pesë) faza 48-orëshe”.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe IAL-të publike dhe jopublike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTRI

Besa SHAHINI

